

**Prishtinë 27/01/2005**

**Kodi i ZRrE-së: C\_01\_2005**

**Për: Z. Sean McGoldrick – Drejtor Ekzekutiv për qështjet Komerciale dhe Rregullative KEK/ESBI**

**Kopje: Z. Ethem Çeku, Ministër i Energjisë dhe Minjerave  
Z. Agron Dida, Zëvendës Ministër i Energjisë dhe Minjerave  
Z. Andreas Wittkowsky, Kryesues i Zyrës Politike dhe Ligjore, UE Shtylla IV**

**Lënda: Pëlqimi për Draft Bilancin Vjetor Elektroenergjetik për vitin 2005**

### **Zyra e Rregullatorit të Energjisë:**

Sipas Nenit 6.1. të Ligjit nr. 2004/8 “Për Energji” ka paraparë që Ministria e Energjisë dhe Minjerave (“MEM”) duhet të miratojë një Bilanc Vjetor Elektroenergjetik bazuar në propozimin nga Operuesi i Sistemit të Transmisionit, pas konsultimeve me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (“ZRrE”).

ZRRE-ja ka inicuar procedurën e vendosur në nenin 6.1 duke i kërkuar KEK-ut që të dorzojë Bilancin e vet Vjetor Elektroenergjetik të vitit 2005, për konsultim. KEK-u i ka dorëzuar ZRrE-së Draftin e Bilancit, Ref. nr 7414-të datës 24.11.2004, i cili është shqyrtuar nga ZRrE-ja dhe komentet i janë dorëzuar KEK-ut. Si rezultat i kësaj KEK-u më 25.01.2005 ka dorëzuar verzionin e përmirësuar të Bilansit të Elektroenergjetik më 25.01.2005.

Drafti i Bilancit Elektroenergjetik për 2005 përfshinë kriteret e propozuara nga ZRrE-ja ashtu si janë të vendosura në Nenin 6.5 të Ligjit të Energjisë, duke përfshirë kriteret shtesë të vendosura në mungesë të Rregullit për Bilancin Elektroenergjetik (Neni 6.6 i Ligjit për Energji).

Pas konsultimeve të brendëshme dhe bashkëpunimit me KEK-un, ZRrE-ja jep pëlqimin e vetë për draftin në tërësi, me disa rezerva mbi qështjet, si në vijim:

- a) Termocentrali “Kosova B1” është paraparë të ketë tre muaj rehabilitim, pa u siguruar që fondet e nevojshëm do të aprovohen në buxhetin e vitit 2005.
- b) Bilanci Elektroenergjetik mbështetet në rritjen e prodhimit të Termocentralit “Kosova A”. Është brengosës fakti se a do të mundet me të vërtetë “Kosova A” të siguroj prodhimin e parashikuar. Kjo është e ndërlidhur me projektet e veçanta, të

planifikuara ose ato në zhvillim për rehabilitimin e “Kosovës A”. Ende mbeten të padefinuara se cilat fonde do të sigurohen nga buxheti i aprovuar për 2005.

- c) Fondet, të cilat do të duhej të ipen për sigurimin e importit të planifikuar të energjisë elektrike për 2005, gjithashtu nuk janë siguruar, si pjesë e buxhetit 2005.
- d) Kur krijohet nevoja për rehabilitimin e Termocentralit Kosova B1, është e qartë se vendimi kur do të bëhet remonti, do të përcaktoj pragramin e importit/exportit. Sipas treguesve të çmimeve mesatare të kontraktuara të importit për tri vitet paraprake, Tetori (kur Rezervat Mergjinale për mbulimin e fuqisë që mungon janë më të ulta) është njëri ndër muajt më të shtrenjtë, përderisa në Maj (kur Bilanci Elektroenergjetik tregon teprica) çmimet e importit janë më të ultat. Sidoqoftë duhet të theksohet se fleksibiliteti i KEK-ut kufizohet nga afatet e remonteve që duhet të ekzekutohen nga kontraktorët. Ne nuk kemi marrë asnjë analizë gjithëpërfshirëse që ka të bëjë me optimizimin e programit të importit (përballë uljes së shpenzimeve totale dhe maksimizimit të të hyrave nga shitja e energjisë elektrike).

ZRrE-ja është e vetëdijshme që përgaditja e Bilancit Elektroenergjetik duhet t’i referohet udhëzimeve për planifikim të publikuar nga UCTE-ja “Doracak Operacional”, dhe “Termet e Bilancit Elektroenergjetik”. Duke pasur parasysh kushtet e tanishme të Sistemit Energjetik të Kosovës, mungesa e fondeve ashtu siç është përcaktuar më lartë si dhe mungesa e legjislacionit përkitazi me Nenin 6.6 të Ligjit të Energjisë, disa elemente të udhëzimit nuk janë marrur në konsideratë.

Si konkludim Zyra e Rregullatorit për Energji sygjeron KEK-un që të dorzoj për aprovim Draft Bilancin Elektroenergjetik për 2005, Ministrisë për Energji dhe Minjera.

**Në emër të ZRrE-së**

---

**Dr. Nick F Frydas**  
**Kryesues i Komisionit**